




Republika e Kosovës
Republika Kosova ~ Republic of Kosovo

KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE ~ INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



ANALIZA E TREGUT TË REKLAMËS NË KOSOVË



Implementuar nga:

Management
Development
Associates **MDA**

Developing Managers. Managing Development.

Vërejtje

Këndvështrimet e paraqitura në këtë raport të hulumtimit mbi Analizën e Tregut të Reklamës në Kosovë janë të autorit dhe jo domosdo përfaqësojnë ato të Komisionit të Pavarur për Media. Përmbajtja e raportit konsiderohet publike dhe mund të shpërndahet lirshëm.

Ekipi i projektit

Ekipi menaxhues:

Burim Leci, Menaxher i Projektit

Ylber Beqiri, Koordinator i Projektit dhe Kontrollues i kualitetit të hulumtimit

Enver Gashi, Ekspert për Metodologji dhe Statistika

Personeli i angazhuar nga Komisioni i Pavarur për Media:

Liridon Dalipi, Recenzent si dhe menaxher i projektit

Përpiluesit e raportit:

Vera Rexhepi

Blendrit Elezaj

Kontrollerët e hulumtuesve në terren dhe sigurimi i cilësisë:

Kushtrim Gojani, Ylber Havolli, Merita Heta, Jeton Hajdari dhe Arbenita Alidema.

Procesimi kompjuterik i pyetsorëve:

Arbenita Alidema, Jeton Hajdari, Qëndrim Jashari dhe Ylber Havolli

Përpunimi grafik i statistikave:

Bardhyl Musa

Hulumtuesit e angazhuar për hulumtimin në terren:

Prishtinë: Elena Kelmendi, Rron Rexha, Blend Doda, Baton Doda, Granit Geci, Zana Tabaku

Mitrovicë: Fitore Sadiku, Blerta Hajra

Gjakovë: Vlora Dervishi, Besmir Juniku

Ferizaj: Kastriot Mehmeti, Qëndrim Frangi, Triumf Hyseni

Prizren: Nita Reshtani, Tringa Siqeca, Liridona Shehu

Pejë: Suzana Broqi, Liridona Demaj

Gjilan: Drenusha Fazliu

Përmbajtja

EKIPI I PROJEKTIT	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
TË GJETURAT KRYESORE.....	6
HYRJE	7
METODOLOGJIA.....	9
KARAKTERISTIKAT E PJESËMARRËSVE NË HULUMTIM	11
KOMPANITË E NDRYSHME PJESËMARRËSE	11
ORGANIZATAT MEDIATIKE PJESËMARRËSE NË HULUMTIM	12
PREFERENCAT REKLAMUESE TE KOMPANIVE PJESËMARRËSE	13
RËNDËSIA E REKLAMIMIT NË KOMPANITË PJESËMARRËSE	13
MEDIAT E PREFERUARA	19
LLOJET E PREFERUARA TE REKLAMIMIT	26
UEB-REKLAMIMI	28
PIKETIMI	31
FAKTORËT NDIKUES NË VEPRIMTARINË REKLAMUESE DHE DIGJITALIZIMI	34
ÇMIMIMI SI FAKTOR NDIKUES NË TREGUN E REKLAMIMIT	34
PENGESAT NË REKLAMIM	35
KUPTIMI I ROLIT TË REKLAMIMIT NË SUKSESIN E KOMPANISË.....	36
DIGJITALIZIMI DHE KOSTOJA E REKLAMIMIT	37
NDRYSHIMET E PËRCEPTUARA TE KALIMIT NË TRANSMETIM DIGJITAL	38
IMPORTUESIT E PAJISJEVE TELEVIZIVE NË KOSOVË.....	39
ORGANIZATAT MEDIATIKE: TË HYRAT VJETORE DHE ÇMIMET	41
<i>Të hyrat vjetore të medimeve nga reklamata.....</i>	<i>41</i>
<i>Çmimet për reklamim në organizatat mediatike</i>	<i>43</i>
PËRSHTYPJET E MEDIUMEVE MBI TREGUN E REKLAMËS.....	44
QASJET REKLAMUESE TË INDUSTRIVE TË NDRYSHME.....	44
KUPTIMI DHE VETËDIJËSIMI I KOMPANIVE KOSOVARE PËR RËNDËSINË E REKLAMIMIT	45
PËRSHTYPJET MBI PREFERENCAT E KOMPANIVE KOSOVARE PËR REKLAMIM.....	45
PËRSHTYPJET MBI DREJTIMIN E TRENDIT TË REKLAMIMIT TË KOMPANIVE	46
PENGESAT E PERCEPTUARA NE TREGUN E REKLAMES	47
PËRSHTYPJET E MEDIUMEVE MBI NDIKIMIN E PROCESIT TË DIGJITALIZIMIT NË TREGUN E REKLAMËS	48
NDRYSHIMET E PERCEPTUARA.....	48
PËRFITIMET E MEDIUMEVE NGA DIGJITALIZIMI	48
HUMBJET E MEDIUMEVE NGA DIGJITALIZIMI	48
SFIDAT.....	49
ÇMIMET SI PENGESË KRYESORE NË TREGUN E REKLAMËS.....	49
PROBLEMET E INDUSTRIVE/KOMPANIVE TË NDRYSHME NË LIDHJE ME REKLAMIMIN E TYRE	49
MUNGESA E NJOHURIVE MBI PROCESIN E DIGJITALIZIMIT	49
KONKLuzionET	50
Aneks i: Pyetësori - Analizë e Tregut të Reklamës.....	52
Aneks ii: Pyetësori - Analizë e Tregut të Reklamimit në Organizatat Mediatike	60
Aneks iii: Raporti i Detajuar Statistikor	65
Aneks iv: Emrat e Kompanive dhe Organizatave Mediatike Pjesëmarrëse.....	84

Përmbledhje Ekzekutive

Informacione mbi Hulumtimin

Hulumtimi “Analiza e Tregut të Reklamës në Kosovë” është disejnuar nga MDA, për të ngritur nivelin e njohurive sa i përket tregut të reklamës dhe përshtypjet e kompanive pjesëmarrëse në aktivitete reklamuese, dhe poashtu të organizatave mediatike të cilat ofrojnë shërbime të reklamimit. Poashtu, pjesë e këtij hulumtimi kanë qenë edhe importuesit e pajisjeve të transmetimit televiziv, e cila është pjesë e vazhduar e hulumtimit të mëparshëm për “Gatishmërinë e Qytetarëve për Procesin e Kalimit në Transmetim Digjital”, me qëllim të analizimit të nivelit të vetëdijësimit të importuesve mbi pajisjet digjitale dhe poashtu mbi procesin e digjitalizimit në përgjithësi. Ky projekt është duke u bërë në emër të Komisionit të Pavarur për Media në lidhje me projektin për digjitalizimin e teknologjisë së transmetimit të sinjalit, gjë që do të ndryshojë edhe tregun e reklamës në forma të ndryshme.

Hulumtimi ka përfshirë një mostër reprezentative prej 633 kompani të ndryshme kosovare, të cilat janë pjesë e të gjitha industrive vepruese në Kosovë. Nga këto kompani, 600 prej tyre janë biznese ndërsa 33 janë organizata mediatike të cilat, ndër të tjera, ofrojnë edhe shërbime reklamimi.

Të Gjeturat Kryesore

- Më shumë se 75% e kompanive në Kosovë nuk kanë buxhet të ndarë vjetor për reklamimin e kompanive të tyre.
- Televizionet lokale janë në përgjithësi më të favorizuara për reklamim nga kompanitë pjesëmarrëse, në krahasim me televizionet kombëtare.
- Nga mjetet e tjera të reklamimit, billbordët mbeten njëra ndër alternativat që preferohet më shumë nga ndërmarrjet.
- Grupet më të piketuara nga bizneset në Kosovë mbesin moshat prej 19 deri në 30 vjeç, gjinia mashkullore, dhe të gjitha etnicitetet pa dallim.
- Sipas organizatave mediatike, ekziston një shkallë jo shumë e lartë e vetëdijësisimit të kompanive kosovare për rëndësinë e reklamimit në biznes.
- Problem tjetër që ndërlidhet me koston e reklamimit, është edhe kostoja e lartë për kompanitë e mesme dhe të vogla për të mbajtur individ apo department të veçantë përgjegjës për reklamim.
- Pritshmëritë lidhur me ndryshimin e tregut të reklamimit përmes digjitalizimit të transmetimit janë të larta, 50.7% konsiderojnë se do të ketë ngritje të kualitetit të reklamave përmes ngritjes së cilësisë së transmetimit; 14.3% konsiderojnë se do të ketë kosto më të ulët të reklamimit; përderisa 14.0% e kompanive janë shprehur se nuk e dijnë një gjë të tillë; dhe 5.3% besojnë se nuk do të ndryshojë asgjë. Kosova po përgatitet të kalojë në sistemin digjital, dhe normalisht kjo do të ketë një efekt edhe në koston e reklamimit.
- Nga ky hulumtim 93.3% e kompanive janë përgjigjur se digjitalizimi do të ketë një efekt pozitiv, ndërsa vetëm 6.7% mendojnë se digjitalizimi do të ndikojë negativisht, duke ngritur koston e shërbimeve dhe hapësirës reklamuese.
- Industritë që reklamojnë më së shumti janë administratë publike 85.7%; financa 77.1 %, ndërsa ato më së paku janë shërbimet komunale 11.4%.

Hyrje

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 19 dhjetor 2012 dorëzoi Draft Strategjinë “Analiza e tregut të reklamës në Republikën e Kosovës” Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me këtë draft strategji KPM ka ofruar propozime që fuqizojnë interesin maksimal, në radhë të parë, të Kosovës, interesin e akterëve të industrisë mediale dhe zhvillimin e pluralizmit medial.

Me qëllim të analizimit të tregut të reklamës në Republikën e Kosovës, Komisioni i Pavarur për Media (KPM), rregullator i pavarur për rregullimin dhe zhvillimin e transmetimit të aspekteve programore dhe zbatimit të politikave, ka angazhuar kompaninë MDA të realizojë projektin “Analiza e tregut të reklamës në Republikën e Kosovës”, ku përfshihen kompani nga industri të ndryshme vepruese në Kosovë.

Ky hulumtim ka për qëllim mbledhjen e të dhënave nga kompanitë private dhe publike, lidhur me realizimin e planifikimeve buxhetore të tyre për reklamim, si dhe identifikimin e tregut medial (p.sh. sa reklamohet në Televizione, në Radio dhe në Ofrues të Shërbimeve Programore).

Ky hulumtim poashtu ka përfshirë pjesën për importuesit e paisjeve të transmetimit digjital, e cila është bërë me qëllim të kuptimit të nivelit të gatishmërisë së qytetarëve për kalimin nga perspektiva e shitësve të paisjeve dhe të shkallës së vetëdijësimit të importuesve në lidhje me këto paisje dhe rëndësinë e digjitalizimit në përgjithësi.

Projekti ka përgatitur pyetësorët në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe serbe. Pas marrjes së aprovimit të pyetësorit nga KPM, MDA ka filluar me mbledhjen e të dhënave nga terreni në regjionet e përcaktuara. Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave nga terreni janë hasur vështirësi në marrjen e informatave nga kompanitë private dhe publike lidhur me buxhetin e tyre vjetor të planifikuar për reklamim.

Nga të dhënat e grumbulluara dhe procesuara nga terreni mund të konkludojmë që kompanitë nga sektori privat dhe publik i kushtojnë rëndësi të madhe marketingut. Për më shumë, ato kanë të ndarë buxhetin vjetor për marketing dhe qëndrojnë mjaft mirë me realizueshmërinë e tij.

Objektivat e Hulumtimit

Objektivat e këtij hulumtimi janë:

- Kuptimi i gjendjes momentale të tregut të reklamës;
- Rëndësinë që kompanitë i kushtojnë marketingut;
- Niveli i investimeve të raportuara në këtë sektor nga ana e kompanive pjesëmarrëse dhe krahasimi i këtyre vlerave me raportet e organizatave mediatike;

- Ndarjen e tregut medial dhe arsyet kryesore të ndarjes së tillë;
- Identifikimi i barrierave dhe / ose motivuesve në tregun e reklamimit;
- Kuptimi i nivelit të vetëdijësimit të importuesve të paisjeve të transmetimit digjital mbi paisjet që shesin, procesin e digjitalizimit, dhe informacionet që u japin konsumatorëve.

Metodologjia

Hulumtimi “Analiza e tregut të reklamës në Republikën e Kosovës” ka për qëllim të analizoj tregun e reklamës nga perspektiva e ndërmarrjeve dhe po ashtu nga ana e operatorëve transmetuese në Kosovë.

Hulumtimi është realizuar me anë të një mostre reprezentative prej 633 respondentë. Anketa u realizua kokë më kokë, me metodologji të intervistës duke përdorur si instrument kryesor pyetësin, dhe zgjedhjes së respondentit nëpërmjet mostrës së rastësishme. Në realizim të hulumtimit në vend të pyetësit të shtypur është përdorur teknologjia më e fundit për realizimin e anketave nëpërmjet tabletave, kjo teknikë sjell rritje të cilësisë në grumbullim të informatave dhe mundësia e gabimit është në masën 0%. Gjithashtu grumbullimi i të dhënave nëpërmjet tabletave krijon mundësin e sistemit të të dhënave drejtpërdrejt në databazë.

Zgjedhja e mostrës së ndërmarrjeve për t’u intervistuar është përcaktuar duke kalkuluar numrin total të ndërmarrjeve në Kosovë (marrë nga repertori statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë TM1-2013) 53500 ndërmarrje, dhe duke përdorur intervalin e konfidencës 3.87 e cila jep numrin prej 633 respondentëve. Me këtë numër të respondentëve sigurohemi që rezultatet e hulumtimit të kenë 95 përqind besueshmëri (niveli i konfidencës), dhe me një marzhë të gabimit prej 3.8 përqind (intervali i konfidencës).

Ndarja e mostrës në bazë të madhësisë së ndërmarrjeve është bërë duke e ndarë mostrën në 4 kategorizime të ndërmarrjeve;

- Ndërmarrje e madhe, me mbi 250 punëtorë me gjithsej **26** të anketuar
- Ndërmarrje e mesme, me më pak se 250 punëtorë me gjithsej **32** të anketuar
- Ndërmarrje e vogël, me më pak se 50 punëtorë me gjithsej **115** të anketuar
- Ndërmarrje mikro, me më pak se 10 punëtorë me gjithsej **427** të anketuar

Tabela 1: Ndarja e mostrës në bazë të madhësisë së ndërmarrjeve

	Ndërmarrje e madhe, me mbi 250 punëtorë	Ndërmarrje e mesme, me më pak se 250 punëtorë	Ndërmarrje e vogël, me më pak se 50 punëtorë	Ndërmarrje mikro, me më pak se 10 punëtorë	Total
% e mostrës	4.3%	5.3%	19.2%	71.2%	100%

Ndarja e mostrës në bazë të llojit të mediumit është bërë duke caktuar gjithëpërfshirjen e llojeve mediatike;

- TV kombëtar me gjithsej 3 të anketuar
- TV lokale me gjithsej 7 të anketuar
- TV kabllore me gjithsej 5 të anketuar
- Radio kombëtare me gjithsej 1 të anketuar
- Radio lokale me gjithsej 16 të anketuar
- Internet me gjithsej 1 të anketuar

Tabela 2: Ndarja e mostrës në bazë të llojit të mediumit

	TV kombëtar	TV lokale	TV kabllore	Radio kombëtare	Radio lokal	Internet
% e mostrës	10%	21%	15%	3%	48%	3%

Ekipi nga MDA në bashkëpunim me zyrtarët e KPM-së kanë hartuar pyetësoin që në përmbajtje siguron qëllimin e hulumtimit, pastaj është realizuar një trajnim për intervistuesit nga eksperti i hulumtimeve mbi përmbajtjen e pyetësoit dhe mostrës për secilën komunë.

Pas trajnimit është pilotuar një numër prej gjithsej 15 pyetësorë në të gjitha komunat, duke u siguruar se sistemi i grumbullimit të dhënave nëpërmjet Tabletave është funksional dhe përjashton gabimet dhe gjithashtu për tu siguruar se pyetësoi është i kuptueshëm për të gjitha shtresat shoqërore.

Të gjitha analizat statistikore dhe përpunimi i të dhënave janë realizuar duke përdorur softverin SPSS (Pakoja Statistike për Shkenca Sociale).

Karakteristikat e Pjesëmarrësve në Hulumtim

Kompanitë e Ndryshme Pjesëmarrëse

Kompanitë të cilat kanë qenë pjesëmarrës në hulumtimin e tregut të reklamës kanë qenë shumica pjesë e kategorizimit si “Ndërmarrje mikro, me më pak se 10 punëtorë”, grup ky i cili ka përbehët nga më shumë se 70% e bizneseve pjesëmarrëse. Më pas vijojnë ndërmarrjet e vogla (19.2%), ndërmarrjet e mesme (5.3%) dhe ato të medha (4.3%). Shih grafikonin e mëposhtëm në lidhje me këtë kategorizim.




Figura 1: Kategorizimi i kompanisë në bazë të numrit të punëtorëve

Nga numri total i 600 kompanive të intervistuar, 36% e tyre i përkasin industrisë së tregtisë me shumicë dhe pakicë, 26.5% shërbimeve sociale dhe personale, ndërsa grupe të tjera më të mëdha janë industria e prodhimit (10.8), transportit dhe komunikimi (7.0%), dhe hotelierisë dhe restoranteve (5.8). Këto përqindje përkohje edhe me përqindjet e përgjithshme të industrive vepruese në Kosovë:




Figura 2: Kategorizimi i kompanisë në bazë të industrisë në të cilën vepron

Organizatrat Mediatike Pjesëmarrëse në Hulumtim

Nga 33 organizatat mediatike të cilat kanë marrur pjesë në këtë hulumtim, 48% janë paraqitur si ndërmarrje mikro të cilat kanë më pak se 10 punëtorë. Këto kompani janë zakonisht medime lokale të cilat nuk kanë kapacitet të lartë transmetimi dhe të cilat përbëjnë shumicën e medimeve në Kosovë. Grupi tjetër më i madh i medimeve ka qenë ai i ndërmarrjeve të vogla ose ato me më pak se 50 punëtorë, e cila përbën 34.3% e të anketuarëve nga organizatat mediatike. Grupet më të vogla përfshijnë ndërmarrjet e mesme me më pak se 250 punëtorë (5.7%), dhe ato të mëdha me mbi 250 punëtorë (11.4%). Grafiku në vijim paraqet kategorizimin e kompanive në bazë të numrit të punëtorëve.




Figura 3: Kategorizimi i kompanisë në bazë të numrit të punëtorëve

Më shumë se 45% e mediumeve në hulumtim kanë qenë radio lokale, rezultat ky i cili lidhet më kategorizimin e mëlartëm të kompanive, ku shihet një përqindje e madhe të ndërmarrjeve të vogla dhe mikro, ku një pjesë e madhe përbëhet nga këto radio. Televizionet lokale me 21%, televizionet kombëtare 10%, dhe TV Kablllore (Ofruesit e Shërbimeve Kablllore), janë tri grupet tjera me më shumë përfshirje në këtë hulumtim.




Figura 4: Mediumet pjesëmarrëse në hulumtim

Preferencat Reklamuese të Kompanive Pjesëmarrëse

Rëndësia e Reklamimit në Kompanitë Pjesëmarrëse

Kompanitë kosovare në përgjithësi i kushtojnë rëndësi planifikimit të reklamimit të tyre, pasi që vetëm 14.67% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk e dinë nëse kanë individë apo grupe përgjegjëse me këtë funksion, me fjalë të tjera, nuk kanë ndonjë përgjegjës specifik për çështje reklamuese. Kështu, 10.67% e kompanive kanë departamente të veçanta brenda kompanive të tyre të cilat mirren më planifikimin e reklamimit. Shumica e kompanive, më saktësisht 70.33% e tyre, kanë persona përgjegjës brenda kompanisë së tyre të cilët janë përgjegjës, ndërsa vetëm 4.33% janë potencuar se kanë kompani apo individ jashtë ndërmarrjes të cilët udhëheqin planifikimet reklamuese të tyre.




Figura 5: Statistikat mbi organizimin e brendshëm të kompanive sa i përket reklamimit

Njëra ndër mënyrat e kuptimit të rëndësisë së reklamimit në kompanitë kosovare është analizimi i shumave të ndara buxhetore për shpenzimet reklamuese të këtyre kompanive. Nga kompanitë e intervistuar, vetëm 24.5% e tyre janë deklaruar se kanë buxhet të ndarë vjetor për reklamim të kompanisë:




Figura 6: Ndarja e buxhetit vjetor për reklamim

Nëse kjo pyetje shikohet nga aspekti strukturor i kompanive të anketuara, shihet se shumica e ndërmarrjeve të mëdha kanë një buxhet vjetor të caktuar (84.6%). Një përqindje pozitive shprehet edhe tek ndërmarrjet e mesme (65.6% PO), ndërsa ndërmarrjet e vogla dhe ato mikro, të cilat përbëjnë shumicën në anketim, nuk kanë buxhet të ndarë vjetor për reklamimin e ndërmarrjeve të tyre.




Figura 7: Ndarja e buxhetit vjetor për reklamim në bazë të llojit të ndërmarrjes

Nga figura e shfaqur më lartë mund të kuptojmë që sa i përket ndarjes së buxhetit vjetor për reklamim, në bazë të llojit të ndërmarrjes, 84.6% të ndërmarrjeve të mëdha të intervistuar, janë shprehur se kanë buxhet të ndarë vjetor, 65.6% të ndërmarrjeve të mesme janë shprehur poashtu se kanë buxhet të ndarë vjetor për reklamim, ndërsa 53.9% e ndërmarrjeve të vogla dhe 88.1% të ndërmarrjeve mikro kanë thënë se nuk kanë buxhet të ndarë vjetor për reklamim.

Në aspektin industrial, kompanitë financiare prijnë me planifikim buxhetor, pasi që janë i vetmi sektor ku ka përqindje më të madhe të kompanive që kanë buxhet të ndarë për reklamim (66.7%) në dallim prej atyre që nuk kanë (33.3). Natyra e veprimtarive të industrive të tjera ka ndikuar që të mos ketë planifikim të madh buxhetor për reklamim. Në këtë mënyrë sektorët si prodhimtaria, hotelieri dhe restorante, e shumë sektorë të tjerë nuk kanë planifikim të specifikuar reklamues. Për më tepër ju lutem referojuni figurës më poshtë.




Figura 8: Ndarja e buxhetit vjetor për reklamim në bazë të llojit të industrisë




Figura 9: Niveli i realizimit të planeve buxhetore për reklamim në bazë të llojit të ndërmarrjes

Nga grafiku më lartë shihet që, nga kompanitë e intervistuar, tek 58.8% të ndërmarrjeve të mëdha shuma vjetore e planifikuar (në euro) për reklama është mbi 100,000 euro, tek 29.4% të ndërmarrjeve të mesme të intervistuar shuma vjetore e

planifikuar për reklamim është nga 5001-10000, dhe 39.6% të ndermarrjeve të vogla kanë ndarë buxhet vjetor për reklamim prej 1001-5000 euro.




Figura 10: Vlera e përafërt e tregut të reklamës në Kosovë ndarë për medime

Nga vlera totale e tregut të reklamës në Kosovë, dhe nga grafiku më lartë, vërejmë që, nga ndermarrjet e intervistuar, ndermarrjet më së shumti reklamojnë në TV lokale me gjithsej 22% apo 6,502,499 euro, TV kombëtare 20% apo 5,989,144 euro, në Radio lokale 17% apo 4,990,953 euro, në gazeta 12 % apo 3,422,368 euro, në Radio kombëtare 14% apo 4,021,282 euro, TV kabllore 7% apo 2,081,940 euro, ndërsa reklamimi në internet me 3% apo 912,631 euro.

Vlera e përafërt e tregut të reklamës në Republikën e Kosovës është fituar duke kalkuluar vlerën mesatare të reklamës për kompani, e përftuar nga ky hulumtim, dhe duke e shumëzuar atë me numrin e përgjithshme të kompanive që paguajnë tatim në Kosovë. Dhe për këtë mund të themi se kompanitë në Kosovë ndajnë rreth 30 milojnë euro për reklamim.

Tabela 3: Ndarja e tregut të reklames në bazë të mediumit

Mediumi	Përqindja	Vlera monetare
TV - kombetare	20%	€ 5,989,144
TV - lokale	22%	€ 6,502,499
Radio - kombetare	14%	€ 4,021,282

Radio - lokale	17%	€ 4,990,953
Internet	3%	€ 912,631
Gazeta	12%	€ 3,422,368
TV - kabllore	7%	€ 2,081,940
Tjera	6%	€ 1,711,184
Vlera e përafërt e tregut të reklamës në Kosovë		€ 29,632,000

Në pyetjen se a keni arritur të realizoni planin buxhetor për reklamim, ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme qendrojnë mjaft mirë në nivelin e realizimit, me shumicën e tyre të pozicionuar te “50% -80%” dhe “100%” të kompletimit të këtij plani. Përqindje më të madhe të dështimeve të plota në realizimin e planit për reklamim shihet më shumë te ndërmarrjet mikro dhe ato të mesme, me 0% dështime te ndërmarrjet e mëdha. Në përgjithësi vërehet një tendencë pozitive në realizimin e planeve buxhetore:




Figura 11: Niveli i realizimit të planeve buxhetore për reklamim në bazë të llojit të ndërmarrjes

Për më tepër, në krahasimin e përgjigjeve totale sa i përket kësaj pyetje, shohim se një pjesë e madhe e kompanive ka arritur ta realizojë planin e tyre buxhetor pjesërisht, prej mbi 0 e deri në 80%, që paraqet me shumë se 75% e të anketuarëve. Mbi 10% kanë arritur që t’i realizojnë plotësisht planet buxhetore për reklamim, ndërsa 12% kanë dështuar krejtësisht në realizimin e tyre:




Figura 12: Niveli i realizimit të planeve buxhetore për reklamim

Mediat e Preferuara

Në pyetjen “Cilin medium të komunikimit e preferoni më shumë”, kompanitë pjesëmarrëse kanë pasur mundësinë që të caktojnë rendësinë e secilit medium ekzistent në preferencë të ulët, të mesme, dhe të lartë.

Një pjesë e madhe e të anketuarëve nuk i preferon edhe aq Televizionet kombëtare, përveç ndërmarrjeve të vogla ku përgjigjja “I lartë” është më e votuara:




Figura 13: Mediumet e preferuara të komunikimit në bazë të llojit të ndërmarrjes – TV Kombëtare

Televizionet lokale kanë shtrirje më të vogël, por preferohen më shumë nga ndërmarrjet e mëdha, ato të mesme dhe të vogla, e më pak nga ato mikro.




Figura 14: Mediumet e preferuara të komunikimit në bazë të llojit të ndërmarrjes – TV Lokale

Radiot kombëtare, ndonëse më mirë se televizionet kombëtare, gjenden prapë në preferencë të ulët tek ndërmarrjet, veçanërisht ato mikro dhe të vogla. Ndërmarrjet e mesme kanë dhënë numër të barabartë të përgjigjeve për radiot kombëtare si preferencë të lartë, ashtu edhe të ulët.




Figura 15: Mediumet e preferuara të komunikimit në bazë të llojit të ndërmarrjes – Radio Kombëtare

Ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme më së shumti preferojnë radiot lokale, ndërsa ndërmarrje e vogla dhe ato mikro nuk kanë preferencë të ulët sa i përket këtij mediumi. Poashtu, vërehet një ngjashmëri përgjigjesh në nivelin e mesëm të preferencës së radiove në ndërmarrjet e mesme, të vogla dhe mikro.




Figura 16: Mediumet e preferuara të komunikimit në bazë të llojit të ndërmarrjes – Radio Lokale

Ndërmarrjet e mëdha kanë një shkallë të ulët të interesimit në internetin si medium reklamues, ndërsa vërehet një ndërlidhje indirekte në mes të preferencës së internetit dhe madhësisë së kompanive. I njëjti mosinteresim shfaqet edhe në përshtypjet e ndërmarrjeve të mëdha mbi gazetën, ku më shumë se 65% e tyre janë deklaruar se interesimi i tyre në këtë medium është i ulët. Megjithatë, në këtë rast nuk vërehet ndonjë trend i qartë në mes të madhësisë së ndërmarrjes dhe përshtypjeve mbi gazetën si medium të komunikimit.




Figura 17: Mediumet e preferuara të komunikimit në bazë të llojit të ndërmarrjes – Interneti




Figura 18: Mediumet e preferuara të komunikimit në bazë të llojit të ndërmarrjes – Gazeta

Një mënyrë ndryshe e qasjes vërehet në rastin e televizioneve kablore, ku një pjesë e madhe e ndërmarrjeve pjesëmarrëse e preferojnë shumë si menyrë e reklamimit. Një

gjë e tillë vërehet më pak te mikro-ndërmarrjet, të cilat do të mund të jenë ndikuar nga çmimet përgjithësisht më të larta të reklamimit në këtë medium.




Figura 19: Mediumet e preferuara të komunikimit në bazë të llojit të ndërmarrjes – TV Kabllore

Kompanitë pjesëmarrëse në këtë hulumtim kanë thënë se përgjigjet e tyre në pyetjet e mëlartme janë ndikuar nga dy arsye kryesore:

- qasje më e lehtë, dhe
- çmime më të lira

Kur kompanitë flasin për qasje më të lehtë, ato flasin për lehtësinë e qasjes së target grupeve të caktuara të kompanive të tyre, gjë të cilën në disa medime do të mund t'a bënin me më shumë vështirësi.

Sa i përket medimeve të cilat janë më të preferuara nga këto kompani, shohim prapë se, megjithëse dallime jo të vogla, janë mediumet lokale të cilat prijnë në këto preferenca me 42%, pasuar nga mediumet kombëtare me 31% dhe ofruesit e shërbimeve programore apo televizionet kabllore me 27%.




Figura 20: Llojet e Medimeve të preferuara

Në grafikun në vijim shohim preferencat mediale në bazë të strukturës dhe numrit të punëtorëve të ndërmarrjeve pjesëmarrëse në anketim. Në bazë të këtij grafiku mund të vërejmë që, 76.9% të ndërmarrjeve të mëdha dhe 71.9% te ndërmarrjeve të mesme preferojnë më shumë mediuemet kombëtare, kurse 49.4% të ndërmarrjeve mikro preferojnë më shumë mediuemet lokale.




Figura 21: Llojet e Medimeve të preferuara në bazë të llojit të ndërmarrjes

Përgjigjet më të përsëritura sa i përket arsyes pse preferojnë këto medime është për shkak se bizneset të cilët i udhëheqin janë biznese lokale (27.2%), apo medimet e caktuara janë më të shikuarat dhe kështu etiketojnë një grup me të madh konsumatorësh.




Figura 22: Arsyet e preferencave të caktuara

Llojet e Preferuara të Reklamimit

Lloji më i preferuar i reklamimit për ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme janë billboardët, ndërsa ato më pak të preferuara janë fletëpalosjet. Sa i përket ndërmarrjeve të vogla dhe mikro, kontakti i drejtpërdrejt me konsumatorët është lloji më i preferuar, ndërsa posterët dhe billboardët mbeten më të papreferuarat për të dy këto. Për më shumë, shihni grafikët në vijim, të cilat paraqesin preferencat e këtyre ndërmarrjeve sa i përket fletëpalosjeve, posterëve, billboardëve dhe kontaktit të drejtpërdrejt me konsumatorë.




Figura 23: Mjetet tjera të Reklamimit - Fletëpalosjet

Sa i përket përdorimit të fletëpalosjeve si mjete të reklamimit, 73.1% të ndërmarrjeve të mëdha dhe 43.8% të ndërmarrjeve të mesme i përdorin në masë të vogël fletëpalosjet, ndërsa 38.2% ndërmarrjeve mikro i përdorin në masë të madhe fletëpalosjet si mjete të reklamimit.




Figura 24: Mjetet tjera të Reklamimit - Posterët

Nga figura 23 mund të shihet që posterët si mjete të reklamimit përdoren në masë të ulët nga ndërmarrjet e intervistuar, kur vërehet që 50% e ndërmarrjeve të mëdha dhe 56% të ndërmarrjeve mikro kanë deklaruar se posterët përdoren shumë pak nga ata.




Figura 25: Mjetet tjera të Reklamimit - Billbordët

Nga figura e shfaqur më lartë mund të kuptojmë që, 26.9% e ndërmarrjeve të mëdha dhe 46.9% të ndërmarrjeve të mesme në masë të madhe përdorin billbordët si mjete të reklamimit, ndërsa 44% e ndërmarrjeve të vogla kanë deklaruar se përdorimi i billbordëve nga ata është në nivel të ulët.




Figura 26: Mjetet tjera të Reklamimit – Kontakti i drejtpërdrejtë me konsumatorët

Sa i përket kontaktit të drejtpërdrejtë me konsumatorët, 26.9% të ndërmarrjeve të mëdha praktikojnë në masë të madhe kontaktin e drejtpërdrejtë me konsumatorë si mjet të preferuar të reklamimit, ndërsa nga ana tjetër 77.3% të ndërmarrjeve mikro kanë thënë që ky mjet i reklamimit përdoret më së shumti nga ana e tyre.

Ueb-Reklamimi

Portalet informative në internet, edhe pse kanë arritur të bëhën pjesë integrale e medimeve informative në Kosovë, ende nuk e kanë arritur rëndësinë që kanë në shtetet e tjera përreth dhe ato të perendimit. Nga të gjitha kompanitë pjesëmarrëse, vetëm 32.7% kanë thënë se bëjnë reklamimin në ueb-faqet zyrtare të medimeve apo në portale informative. Ky numër duket të jetë arritur më reklamimet e ndërmarrjeve të mëdha, prej të cilave më shumë se 80% kanë deklaruar se reklamojnë në këto forma online të informimit. Më poshtë mund të gjeni paraqitjen vizuale totale dhe atë bazuar në llojin e ndërmarrjes sa i përket reklamimit në ueb-faqet zyrtare të medimeve apo në portale informative.




Figura 27: Reklamimi në ueb-faqe zyrtare dhe portale informative




Figura 28: Reklamimi në ueb-faqe zyrtare dhe portale informative sipas llojit të ndërmarrjes

Nga figura 27 mund të vërejmë që sa i përket reklamimit në ueb-faqet zyrtare dhe portalet informative, 80.8% të ndërmarrjeve të mëdha reklamojnë ne ueb-faqet e tyre zyrtare si dhe në portale informative, tek ndërmarrjet e mesme 50% janë deklaruar pozitivisht dhe 50% negativisht, ndërsa tek ndërmarrjet e vogla 57.4% e të intervistuarve kanë deklaruar se praktikojnë reklamimin në ueb-faqet e tyre zyrtare dhe në portale informative.

Pjesëmarrësit në anketim pajtohen në përgjithësi (69.9%) që reklamimi ne ueb-faqe është dukshëm më i lirë, 24.5% të tjerë thanë ase ky lloj i reklamimit është më i lirë, dhe vetëm 4.6% mendojnë se nuk ka dallim në çmim në relacion me format tjera të reklamimit.




Figura 29: Krahasimi i çmimeve të reklamimit online me forma të tjera

Piketimi

Kur pjesëmarrësit janë kërkuar të bëjnë klasifikim e piketimeve të tyre primare gjatë reklamimit në bazë të moshës, gjinisë dhe nacionalitetit, 48.9% e tyre kanë përmendur moshat 19-30 vjeç si piketimin primar, ndërsa më se 39% konsiderojnë konsumatorët nga të gjitha moshat si pikëtimint e tyre primar. Shumica e ndërmarrjeve, ato të mëdha, të mesme, të vogla dhe mikro, kanë pikëtuar moshën 19-30 vjeç si moshat të cilat i pikëtojnë. Poashtu është vërejtur një dallim i madh pikëtimesh së meshkujve më atë të femrave, ku ata të parët janë pikëtuar nga 62% e të intervistuarëve, për dallim nga femrat të cilat pikëtohen nga 38% e kompanive të anketuara. Të gjitha industritë, përveç asaj të bujqësisë, janë deklaruar se i pikëtojnë mëshkujt më shumë se femrat, kjo e fundit ndryshe për shkak të produkteve që i shet dhe konsumatorët të cilët janë më shumë femra. Poashtu, vlen të përmendet se në aspektin e etnicitetit, të gjithë pjesëmarrësit kanë deklaruar se i pikëtojnë të gjitha nacionalitetet në nivel të njëjtë. Referohuni në grafikët e prezentuar më poshtë për informata më të detajuara për informacionet mbi pikëtimet primare të kompanive pjesëmarrëse. Konstatimet e cekura më lartë i gjeni në grafikët e paraqitur më poshtë.




Figura 30: Pikëtimi primar në bazë të moshës




Figura 31: Pikëtimi primar në bazë të moshës në bazë të llojit të ndërmarrjes



Figura 32: Pikëtimi primar në bazë të gjinisë




Figura 33: Pikëtimi primar i gjinisë sipas industrive

Faktorët ndikues në veprimtarinë reklamuese dhe digjitalizimi

Çmimi si faktor ndikues në tregun e reklamimit

Çmimi i reklamave luan një rol shumë të rëndësishëm në tregun e reklamimit. Në pyetjen se sa herë është reklamuar kompania e tyre gjatë vitit 2012, në televizion, në radio në gazetë apo ndonjë media tjetër (për shembull media elektronike), 51.6% e kompanive të anketuara janë përgjigjur se kanë reklamuar së paku 1-10 herë në TV; 53.2% e kompanive kanë reklamuar për 1-10 herë në Radio; 58.5% kanë reklamuar 1-10 herë në gazeta; dhe në medime tjera 37.1% kanë reklamuar 1-10. Kjo tregon se përkundër çmimeve të reklamimit që janë më të larta në TV dhe radio, për shkak të efektit që kanë kompanitë si pasojë e reklamimit në këto medime ato janë të gatshme të paguajnë por kjo vetëm në sekuenca më të rralla.

Tabela 4: Reklamimi i kompanive të anketuara në TV gjatë 2012

Numri i herëve të reklamimit	Total	Ndërm. e madhe, me mbi 250 punëtorë	Ndërm. e mesme, me më pak se 250 punëtorë	Ndërm. e vogël, me më pak se 50 punëtorë	Ndërm. mikro, me më pak se 10 punëtorë
1-10	51.6%	50.0%	30.4%	52.1%	56.2%
101-200	1.8%	0.0%	8.7%	2.7%	0.0%
201-300	3.6%	9.1%	13.0%	4.1%	0.0%
301-500	5.8%	13.6%	4.3%	5.5%	4.8%
500+	1.8%	4.5%	4.3%	1.4%	1.0%

Tabela 5: Reklamimi i kompanive të anketuara në Radio gjatë 2012

Numri i herëve të reklamimit	Total	Ndërm. e madhe, me mbi 250 punëtorë	Ndërm. e mesme, me më pak se 250 punëtorë	Ndërm. e vogël, me më pak se 50 punëtorë	Ndërm. mikro, me më pak se 10 punëtorë
1-10	53.2%	47.6%	27.8%	46.7%	60.3%
101-200	4.7%	4.8%	11.1%	6.7%	2.9%
201-300	4.7%	4.8%	11.1%	8.3%	2.2%
301-500	6.0%	19.0%	5.6%	8.3%	2.9%
500+	1.7%	0.0%	11.1%	0.0%	1.5%

Tabela 6: Reklamimi i kompanive të anketuara në Gazeta gjatë 2012

Numri i herëve të reklamimit	Total	Ndërmarrje e madhe, me mbi 250 punëtorë	Ndërmarrje e mesme, me më pak se 250 punëtorë	Ndërmarrje e vogël, me më pak se 50 punëtorë	Ndërmarrje mikro, me më pak se 10 punëtorë
1-10	58.5%	60.9%	42.1%	58.7%	63.8%
101-200	2.2%	8.7%	0.0%	0.0%	2.1%
201-300	3.0%	4.3%	5.3%	4.3%	0.0%
301-500	2.2%	4.3%	0.0%	2.2%	2.1%
500+	1.5%	0.0%	5.3%	0.0%	2.1%

Tabela 7: Reklamimi i kompanive të anketuara në medium tjera gjatë 2012

Numri i herëve të reklamimit	Total	Ndërm. e madhe, me mbi 250 punëtorë	Ndërm. e mesme, me më pak se 250 punëtorë	Ndërm. e vogël, me më pak se 50 punëtorë	Ndërm. mikro, me më pak se 10 punëtorë
1-10	37.1%	13.0%	22.2%	19.7%	49.4%
101-200	3.2%	0.0%	5.6%	2.8%	3.6%
201-300	12.6%	43.5%	33.3%	26.8%	0.0%
301-500	16.9%	17.4%	11.1%	23.9%	14.5%
500+	2.5%	0.0%	11.1%	0.0%	3.0%

Pengesat në reklamim

Pengesat që hasin kompanitë kur reklamojnë produktet apo shërbimet e tyre janë të ndryshme, duke filluar nga çmimet e larta, kosto e lartë për të mbajtur department apo individ të veçantë përgjegjës për reklamim, mungesë e njerëzve profesional të fushës së reklamimit në vendet ku veprojnë kompanitë, deri tek mungesa e aftësive profesionale të mediave për të përmbushur kërkesat e kompanive.

Në grafikun e mëposhtëm shihet renditja e pengesave sipas shpeshtësisë së paraqitjes tek kompanitë gjatë reklamimit të produkteve/shërbimeve të tyre, nga këtu shihet se problemet më të mëdha janë çmimet e larta, e sidomos për ndërmarrjet mikro që kanë më pak se 10 punëtorë (79.9%) poashtu 52.2% ndërmarrjeve të mëdha me mbi 250 punëtorë deklarojnë se çmimet e reklamave janë si pengesë. Kompanitë e mëdha poashtu deklarohen se pengesë janë edhe mungesa e aftësive të organizatave mediatike (21.7%) dhe mungesa e profesionistëve në rajonin ku veprojnë (17.4%). Përderisa kompanitë më të vogla kanë theksuar si më problematike koston e lartë për të mbajtur department apo individ të veçantë përgjegjës për reklamim.




Figura 34: Pengesat e hasura nga kompanitë gjatë reklamimit të produkteve/shërbimeve

Kuptimi i rolit të reklamimit në suksesin e kompanisë

Kuptimi i rolit të reklamimit në suksesin e kompanisë ka një rëndësi të veçantë jo vetëm për tregun në Kosovë por gjithandej në botë.

Lidhur me faktin se sa e konsiderojnë të rëndësishme kompanitë reklamimin e produkteve/shërbimeve të tyre si një metodë për të arritur sukses dhe depërtuar sa më shumë në treg, ato janë përgjigjur: 54.2% e kompanive konsiderojnë se reklamimi luan një rol shumë të rëndësishëm në suksesin e biznesit të tyre; 37.8% reklamimi luan një rol mesatar në suksesin e veprimtarisë së tyre; 6.3% reklamimi ka një rol të vogël në sukseset e arritura, dhe 1.7% konsiderojnë si krejtësisht të panevojshëm reklamimin për të patur sukses me produktet/shërbimet e tyre. Kryesisht ndërmarrjet e mëdha kanë vlerësuar si shumë të rëndësishëm reklamimin e produkteve/shërbimeve të tyre si premisë për arritje të një suksesi më të madh në treg.




Figura 35: Roli i reklamimit në suksesin e kompanisë

Digjitalizimi dhe kostoja e reklamimit

Kosova po përgatitet të kalojë në sistemin digjital, dhe normalisht kjo do të ketë një efekt edhe në koston e reklamimit. Nga ky hulumtim 93.3% e kompanive janë përgjigjur se digjitalizimi do të ketë një efekt pozitiv, ndërsa vetëm 6.7% mendojnë se digjitalizimi do të ndikoj negativisht, duke ngritur koston e shërbimeve dhe hapësirës reklamuese. Mbi 95% e ndërmarrjeve të vogla presin që digjitalizimi do të ndikojë pozitivisht në koston e reklamimit.



Figura 36: Ndikimi i digjitalizimit në koston e reklamimit-sipas kompanive nga industri të ndryshme

Ndryshimet e përceptuara të kalimit në transmetim digjital

Transmetimi digjital si një proces i ri dhe jo shumë i njohur nga komuniteti i biznesit, natyrisht që rezulton në përceptime të ndryshme nga ana e kompanive. Në pyetjen se si mendojnë se do të ndryshojë tregu i reklamimit përmes digjitalizimit të transmetimit, 50.7% konsiderojnë se do të ketë ngritje të kualitetit të reklamave përmes ngritjes së cilësisë së transmetimit; 14.3% konsiderojnë se do të ketë kosto më të ulët të reklamimit; përdherisa 14.0% e kompanive janë shprehur se nuk e dijnë një gjë të tillë; dhe 5.3% besojnë se nuk do të ndryshojë asgjë.

Tabela 8: Si do të ndryshoj tregu i reklamimit përmes digjitalizimit të transmetimit – sipas kompanive të anketuara

	Totali	Ndërm. e madhe, me mbi 250 punëtorë	Ndërm. e mesme, me më pak se 250 punëtorë	Ndërm. e vogël, me më pak se 50 punëtorë	Ndërm. mikro, me më pak se 10 punëtorë
Ngritja e kualitetit të reklamave përmes ngritjes së cilësisë së transmetimit	50.7%	38.5%	40.6%	46.1%	53.4%
Kosto më të ultë të reklamimit	14.3%	11.5%	15.6%	9.6%	15.7%
Kosto më të lartë të reklamimit	4.7%	11.5%	0.0%	8.7%	3.5%
Ngritja e mundësive të reklamimit për shkak të numrit më të madh të transmetuesve kombëtar	8.0%	23.1%	15.6%	14.8%	4.7%
Ngritja e kostos për shkak të rritjes së shpenzimeve të kompanive mediatike në procesin e digjitalizimit	2.7%	3.8%	0.0%	1.7%	3.0%
Nuk do të ndryshojë	5.3%	3.8%	9.4%	3.5%	5.6%
Nuk e di	14.0%	7.7%	18.8%	14.8%	13.8%
Tjera	0.3%	0.0%	0.0%	0.9%	0.2%

Importuesit e Pajisjeve Televizive në Kosovë

Importuesit e pajisjeve televizive luajnë një rol në procesin e tranzicionit nga sistemi analog në atë digjital, duke e përgatitur tregun me ofertë sa më të mirë të pajisjeve digjitale në mënyrë që konsumatorët të gjejnë mundësi dhe zgjedhje nga më të ndryshmet dhe më të pranueshmet edhe për nga ana financiare. Për këtë arsye, fillimisht është shumë e rëndësishme që vetë importuesit të kuptojnë procesin e digjitalizimit dhe të bëjnë dallimin në mes të televizorëve analog dhe atyre digjital. Nga ky hulumtim rezulton se 56.5% e importuesve bëjnë dallimin në mes të televizorëve analog dhe digjital ndërsa 43.5% e importuesve nuk mund të bëjnë një dallim mes dy llojeve të televizorëve.

Sa i përket përqindjes së televizorëve analog dhe atyre digjital në stoqet e importuesve të anketuar, numri i tyre qëndron në shifrat si: 57% e pajisjeve janë digjitale ndërsa 48% e pajisjeve tjera janë analoge. Sipas kompanive importuese të pajisjeve televizive, 10.7% e kompanive kanë deklaruar se ka konsumatorë që blejnë televizorë analog, 13.3% janë shprehur se nuk ka konsumatorë të televizorëve analog dhe 76% janë shprehur se nuk e dijnë.




Figura 37: Kërkesa e konsumatorëve për televizorë analog

Çmimet e pajisjeve teknologjike të transmetimit digjital nëpër pika shitëse variojnë si: televizorët digjital nga 334.84 euro deri 1179.03 euro; resiverët digjital nga 177.20 euro deri 389.20 euro; dhe pajisjet tjera prej 222.5 euro deri 500.00 euro. Pajisjet teknologjike të transmetimit digjital që të gjitha importohen, dhe ndër vendet e listuara prej nga importohen janë si në vijim: Gjermania, Kina, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për ndryshimet në mes të transmetimit analog dhe digjital, jo gjithmonë konsumatorëve u ofrohet informacion nga kompanitë importuese shitëse. 20% e kompanive deklarohen se gjithmonë i ofrojnë një informacion të tillë konsumatorit, 45.3% ofrojnë informacion vetëm nëse pyeten për të, dhe 34.7% nuk ofrojnë kurrfarë informacioni.




Figura 38: Informimi i blerësve për teknologjinë analoge dhe digjitale nga ana e shitësve

Ndërsa sa i përket njohurive të vetë kompanive importuese për procesin e kalimit në transmetim digjital, 16% janë shumë të informuar, 38.7% janë deri diku të informuar, 34.7% janë pak të informuar dhe 4.0% nuk janë aspak të informuar.




Figura 39: Shkalla e informimit të importuesve/shitësve të teknologjise televizive për procesin e kalimit në transmetim digjital

Organizatave mediatike: Të hyrat vjetore dhe çmimet

Të hyrat vjetore të medimeve nga reklamat

Hulumtimi tregon se të hyrat vjetore të organizatave mediatike nga reklamat për tri vitet e fundit janë:

Për vitin 2012:




Figura 40: Të hyrat vjetore nga reklamat të kompanive mediatike për vitin 2012

Nga figura më lartë mund të shihet që, në bazë të kompanive mediatike të intervistuar, 33.3% të radiove lokale në vitin 2012 kanë pasur të hyra vjetore nga 5001-10000 euro, 50.0% të TV kabllore kanë gjeneruar të hyra prej 10001-20000 euro, ndërsa 50% përqindja e mediave që kanë pasur të hyra mbi 50000 euro është 10.5%. Për më tepër, TV kombëtare nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

Për vitin 2011:




